

DETYRË PROJEKTIMI

Spostimi i linjave TM/TU që ndodhen në aksin e ri rrugor Thumanë- Kashar loti II.”

HYRJE

Detyra e projektimit për spostimin e rrjetit ekzistues TM dhe TU përgjate trasesë së rrugës së re Thumanë-Tapizë, për furnizimin me energji elektrike dhe ruajtjen e standarteve teknike të linjave elektrike përgjate traseve të rrugëve nacionale dhe autostradave.

Kjo do të realizohet me zëvendësimin e segmenteve ekzistues te disa fiderave me kablllo nentokesor të rinj,për shkak të spostimit me qellimin e ndërtimit të aksit të ri rrugor Thumanë-Tapizë.

Ky investim do të përfshijë zonën nga km 0 (Thumanë) – km 12.5 (Ura e Gjolës).

OBJEKTIVAT DHE PERSPEKTIVAT E PROJEKTIT

1. Projekti parashikon të realizojë spostimin e rrjetit ekzistues të shpërndarjes 6 Kv dhe 20 kV (në disa segmente). Ti jap mundësi vazhdimit të punimeve në këtë aks të ri rrugor duke spostuar rrjetin elektrik të tensionit të ulët dhe të mesëm aty ku është e nevojshme. Gjithashtu do të mundësojme zëvendësimin e një kabine shtyllore 6kV, për shkak të gjëndjes së keqe teknike, me kabinë të re në pronësi të kompanisë, brenda të gjitha standardeve teknike dhe normave në fuqi.
2. Projekti do të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike të abonentëve.
3. Zëvendësimi i rrjetit 6Kv dhe 20 kV me linja kablllore pasi krijon lehtësira ne ndërtimin e aksit të ri rrugor Thumanë-Tapizë.
4. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë ndikim të pa kthyeshëm në mjedis, kjo pasi të gjitha territoret ku do të kryhen punime do të kthehen në gjendjen fillestare, materialet që do të përdoren për zbatimin e projektit nuk duhet të kenë lëndë të dëmshme për ambientin dhe mjedisin.

HARTIMI I PREVENTIVAVE.

1. Preventivat do te hartohen dhe në të do të përfshihen:
 - a. Preventiva e sposimeve të disa segmenteve të fiderave ekzistues.
 - b. Preventivi i ndërtimit të kabinës së re 6 kV të tipit shtyllore
 - c. Preventivi i spostimit të rrjetit TU me përcjellësa “ABC” përgjate trasesë.
2. Çmimet për hartimin e preventivave të merren nga manuali teknik i çmimeve të ndërtimit i botuar në fletoren zyrtare.
3. Për punime ose materiale për të cilat nuk ka çmime në manualin zyrtar të hartohen analizat e çmimeve bazuar tek libri Nr. 6 " Montimi i linjave dhe të n / stacioneve " si dhe të atij të " Normave komunale" sipas udhëzimit Nr.2 datë 08.05.2003 dhe të miratohen në “Këshillin Teknik” të OSSH sh.a.
4. Per çmimet e bazës materiale për pajisjet e tjera do të merren për baze çmimet e SAP-it sipas degës ekonomike të OSSH.
5. Preventivat të jenë F.V (Furnizim –Vendosje). Makineri e pasje të jenë të veçuara

SHËNIME TË NDRYSHME.

- Në preventiva nuk do të jetë e përfshirë vlera e shpenzimeve për supervizim kolaudim dhe për truallin ku do të ndërtohet traseja e fiderave.
- Në preventiva nuk do të jetë e përfshirë vlera e shpenzimeve për sigurimin e lejeve të shesheve të ndërtimit dhe të lejeve të ndërtimit.

Konceptoi: